Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

Kryetari i Komunës
01.Nr.670/01-2581/26
Kaçanik, 30.01.2026

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.400/01-21750/25, Vendimit të Kryetarit të Komunës 01.Nr. 670/01-2581/26 i dt. 30.01.2026 si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, shpallë:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

1. Komuna e Kaçanikut, për vitin akademik 2025-2026, do të ndan 60 bursa me nga 50 € në muaj (për 10 muaj) për student të rregullt të studimeve themelore.

Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kushte:

1.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
1.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës dhe Universitetit Shtetëror të Tetovës,
1.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
1.4 të jenë student të vitit të dytë e me lartë,
1.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
1.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Makineri dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor.)

2. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10 dhe drejtimeve deficitare i shtohen 7 pikë.

Studentët përfitojnë pikë tjera në qoftë se i takojnë këtyre kategorive:

- Është fëmijë i kategorive të dala nga lufta (i dëshmorit, i invalidit, i veteranit, i martirit) -i shtohen 2 pikë,
- Është fëmijë nga familja me gjendje të rëndë ekonomike, person me aftësi të kufizuara, - i shtohen 2 pikë,
- Dy e më tepër student të një familje - i shtohen 1 pikë.

3. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

3.1 kërkesa për bursë,
3.2 kopje e dokumentit të identifikimit,
3.3 dëshmia e regjistrimit të vitit akademik 2025-26,
3.4 certifikata e provimeve të dhëna origjinal dhe kopjen e indeksit,
3.5 deklarata e bashkësisë familjare, ekstraktin e lindjes,
3.6 dëshminë se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve,
3.7 dëshmi që i takon kategorisë sipas pikës 2.

Afati dhe mënyra e aplikimit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.)

Afati për aplikim është 15 ditë pune, nga dita e shpalljes së këtij konkursi prej **30.01.2026 deri 19.02.2026.**

Vërejtje: Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë.

Prej një familje mund të jetë përfitues vetëm një student.

Kryetari i Komunës
z. Sabedin Vishi

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA